



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TRYEZËN E RRUMBULLAKËT PËR NDËRTIMIN E QYTETARISË AKTIVE NË SHQIPËRI

13 dhjetor 2011

Zv. Ministre Malaj,
Zv. Ministre Duma,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëdita!

Jam i lumtur t'ju uroj mirëseardhjen në tryezën e sotme të organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri si pjesë e projektit *Ndërtimi i Qytetarisë Aktive*.

Projekti synon të arrijë tek brezat e rinj në Shqipëri. Shqipëria është një demokraci e re dhe ka një popullsi të re.

Dhe të dyja mund të zhvillohen së bashku për të krijuar një të ardhme ndërkombëtare të suksesshme përmes dialogut, ndërgjegjësimit të mëtejshëm dhe pjesëmarrjes aktive.

Është e rëndësishme që të rinjtë të dinë jo vetëm si funksionojnë institucionet demokratike dhe ligji, por edhe se si ata mund të nxiten që të marrin pjesë në zhvillimin kombëtar të Shqipërisë.

Promovimi i qytetarisë aktive përmes të rinjve është thelbësor.

Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë për vitin 2010 tregoi se angazhimi i qytetarëve në nismat sociale dhe ato që lidhen me politikat e ndryshme, shihen si dimensionimi më i dobët i shoqërisë civile.

Projekti synon të promovojë qytetarinë aktive përmes sistemit arsimor.

Ky sistem është i rëndësishëm në krijimin e qytetarisë aktive, duke qenë se shkollat përbëjnë një vend kyç, ku të rinjtë kalojnë shumicën e kohës së tyre dhe ku ata zhvillojnë një sistem vlerash, parimesh, apo e thënë shkurt, një tablo më të qartë të botës.

Gjatë dy viteve të fundit, OSBE-ja ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, duke mbështetur modernizimin e mëtejshëm të edukimit qytetar në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

Në vitin 2010, Prezenca mbështeti një vlerësim të kurrikulës së edukatës qytetare dhe metodave të mësimdhënies për klasat e 9-ta dhe të 10-ta.

Në të vërtetë, vlerësimi tregoi se kishte vend për përmirësim.

Në vitin 2011, kjo çoi në fazën e dytë të projektit, ku u vlerësuan procedurat për zhvillimin e një kurrikule të edukatës qytetare.

Po ashtu, u hartua një propozim për reformimin e kurrikulës së edukatës qytetare në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Institutin për Zhvillimin Arsimor.

Sot, ne po e prezantojmë këtë propozim me synimin për të përmirësuar edukimin qytetar për të rinjtë, që ata të jenë qytetarë më të informuar, më të suksesshëm dhe më të përgjegjshëm.

Zv. Ministre Malaj,
Zv. Ministre Duma,
Zonja dhe zotërinj,

Demokracitë ruhen nga qytetarët, që kanë njohuritë dhe aftësitë e duhura.

Sa më shumë qytetarë të kenë këto dije dhe aftësi, aq më e qëndrueshme mund të jetë demokracia.

Edukimi qytetar është një proces i vazhdueshëm, një proces që përparon dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ky projekt duhet parë si një kontribut në përpjekjet për të krijuar një shoqëri civile që ka vitalitet dhe që, përkrah partive politike, medias dhe faktorëve të tjerë, do të forcojë më tej kuadrin demokratik dhe institucional të këtij vendi.

Do të doja të falënderoja të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë përpjekje dhe t'ju nxis që ta vazhdoni këtë punë të mirë.

Ju faleminderit shumë!

Fund